

## Phrase-Terms in the Terminology of Economics

**Prof. ass. Dr. Sadete Pllana**

University of Prishtina, Faculty of Economics

E-mail: [sadeteplana@hotmail.com](mailto:sadeteplana@hotmail.com)

**Zelfije Abdyli, ecc. dipl.**

MA student at the Faculty of Economics - Prishtina

E-mail: [zelfije.abdyli@uni-pr.edu](mailto:zelfije.abdyli@uni-pr.edu)

**Received:** 30 January 2013; **Revised:** 10 February 2013; **Accepted:** 18 February 2013

**Abstract:** The rapid development of science and technology and the economy make it necessary to create multiple linguistic units which serve for their nomination. For this reason new linguistically enhanced units are formed, unsimplified, stable compound words, which, like words serve to mark objects, phenomena and countless new concepts. The wide expansion of stable compound words in the language, as a specific nominating lexico syntactic unit, especially in the economy, is creating a specific layer in the circuit of terminological vocabulary, which is characterized by certain specific features and attributes.

**Keywords:** terms-phrase, the terminology of economics, sustainable compound words, expanded compound words.

### Hyrje

Në zhvillimin dhe pasurimin e kësaj terminologjie, kanë ndikuar faktorët ekonomik-shoqërorë dhe faktorët gjuhësorë. Kjo terminologji ndoqi hapa pas hapi zhvillimin e ekonomisë e industrisë si dhe shkencat ekonomik-shoqërore, u zhvillua e u pasurua vijimisht si në drejtimin leksikor-semantik, edhe në drejtimin strukturor-fjalëformues, duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të shqipes, krahas rindërtimit të kuptimit të fjalëve, zgjerimit a ngushtimit ose rikuptimësimit të tyre. Trajtimi i problemeve të terminologjisë mund të bëhet nga anë të ndryshme. Në literaturë, sot, ka shumë diskutime rreth konceptit për *terma togfjalësh* dhe për pasqyrimin e tyre në tekstet e ekonomisë. Termi përfaqëson një fjalë ose një togfjalësh që emërton një nocion të caktuar në sistemin e nocioneve të një fushe, të veçantë, të dijes, të shkencës e të teknikës<sup>75</sup> dhe, me përdorim të veçantë funksionon brenda terminologjisë së një fushe. Termat togfjalësha pasqyrohen në fjalorët terminologjikë<sup>76</sup>, por kanë zënë vend edhe në fjalorët shpjegues.

### Togfjalëshat e qëndrueshëm

Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë kanë marrë një përhapje të gjerë në literaturën ekonomike dhe mësimore. Ata janë pasqyruar gjerësisht edhe në fjalorët e ndryshëm terminologjikë. Si njësi të veçanta gjuhësore ata kanë vend edhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980)<sup>77</sup>. A. Duro te togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë, dallon disa shkallëzime, të cilat kushtëzohen si nga karakteri i lidhjes së gjymtyrëve, ashtu edhe nga prejardhja e tyre. Madje, sipas Duros, mund të dallohen katër nëntipa kryesorë, që nga togfjalësha të qëndrueshëm terminologjikë që i shënojnë sendet nëpërmjet një emërtimi tjetër në mënyrë të figurshme, deri te togfjalësha terminologjikë me lidhje relativisht të dobëta të elementeve përbërëse.

<sup>75</sup> A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009; H. Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe, nga Rilindja deri në vitet '80 të shek. XX*, Tiranë, 2005; J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.

<sup>76</sup> N. Rexha, *Fjalor i biznesit, ekonomikës dhe financës anglisht –shqip shqip-anglisht*, ASAU, Prishtinë, 2009; *Fjalor i termave të ekonomisë së transportit shqip-anglisht-frëngjisht-rusisht*, ASHK IGJL, Tiranë, 2002.

<sup>77</sup> *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1980.

Togfjalëshat e qëndrueshëm, duke shënuar nëpërmjet lidhjeve të qëndrueshme të gjymtyrëve të tyre objekte të veçanta të konceptuara si entitete me vete të realitetit, paraqiten si një mjet i efektshëm me një lehtësi të madhe formimi për plotësimin e nevojave të terminologjive të fushave të ndryshme të dijës. Ata pasurojnë leksikun me njësi të reja, krahas mjeteve të tjera fjalëformuese (si prejardhja, përbërja, përngjitja etj.) Togfjalëshat e qëndrueshëm (jofrazeologjikë) nuk janë vlerësuar më parë sa duhet si një pasuri e veçantë leksikore, që plotëson nevojat e komunikimit nëpërmjet njerëzve njësoj sikurse dhe fjalët. Ato, p.sh., janë pasqyruar në mënyrë shumë të cinguar në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të vitit 1954. Duke e konsideruar këtë fakt si një të metë serioze të fjalorit, prof. A. Kostallari shumë vite më parë ka shkruar: “Në çerdhet e fjalorit nuk janë futur shumë togje të qëndrueshme fjalësh që kanë një unitet organik kuptimi dhe përdoren gjerësisht si: *aeroplan gjuajtës, aeroplan vëzhgimi, arsim i lartë, ... marrëdhënie në prodhim, fuqi punëtore ... shtëpi pushimi ...* etj. Fjalët dhe togjet e fjalëve të tilla që mungojnë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” janë me mijëra”<sup>78</sup>. Më vonë këta togfjalësha kanë zënë vend në punimet leksikografike, e sidomos gjerësisht janë dhënë si mjet ilustrues, kurse në raste të veçanta edhe si njësi me vete në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980). Në morinë e togfjalëshave të dhënë mund të takojmë aty një sasi të madhe togfjalëshash të qëndrueshëm (jofrazeologjikë), si të gjuhës së përgjithshme, ashtu edhe të terminologjive të ndryshme.

### Togfjalëshat terminologjikë më specifike

Po kështu, gjerësisht janë dhënë edhe togfjalëshat terminologjikë më specifike. P.sh., tek *pagesë* takojmë: *pagesë e borxhit, pagesë e kamatës, pagesë e menjëhershme, pagesë e parakohshme, pagesë e pjesshme, pagesë e plotë, pagesë e rreme, pagesë e zhëmtimit, kamatë e llogaritur* etj. Konceptet *togfjalësh terminologjik me lidhje relativisht të lirë, togfjalësh terminologjik, togfjalësh i qëndrueshëm terminologjik, emërtim i pathjeshtë apo term i pathjeshtë* etj., do të kushtëzojnë vendin, mënyrën dhe teknikën e paraqitjes së tyre në terminologjinë e ekonomisë. Themelore për terminologun është që togfjalëshat terminologjikë duhet të emërtojnë një koncept. H. Pasho pranon emërtimin *togfjalësh terminologjik*<sup>79</sup>. Kurse A. Duro përdor dhe emërtimin *togfjalësh terminologjik*, dhe emërtimin *togfjalësh i qëndrueshëm terminologjik*<sup>80</sup>. A. Kostallari pranon konceptin se togfjalëshat duhet të jenë njësi gjuhësore të pavarura si dhe termat *emërtim i thjeshtë* edhe *term i pathjeshtë*, pa bërë dallime në mes tyre<sup>81</sup>. Sasia e termave togfjalësha që emërtojnë detaje të reja të nocioneve me të cilat u pasurua terminologjia e ekonomisë:

**Bilanc** – *bilanc aktiv, bilanc bankar, bilanc dinamik, bilanc fillestar, bilanc i eksportit dhe importit, bilanc i falimentimit, bilanc i gjendjes i klasifikuar, bilanc i gjendjes i planifikuar, bilanc i këmbimit të mallrave, bilanc i konsoliduar i gjendjes, bilanci pafavorshëm, bilanc i pagesave, bilanc i parave të gatshme, bilanc pasiv, bilanci bilanc i prodhimit, tregtisë së jashtme, bilanc krahasues, bilanc provizor, bilanc tregtar, bilanc valutor, bilanc vjetor* etj.

**Blerje** - *blerje e anuluar, blerje e matur, blerje e përditshme, blerje impulsive, blerje mallrash të stinës, blerje me afat të prerë, blerje me garanci, blerje me gjedhe, blerje me këste, blerje me kredi, blerje me leverdi, blerje me marrëveshje, blerje me para në dorë, blerje neto, blerje shtetërore, blerje spekulative, blerje valute* etj.

**Buxhet** - *buxhet i balancuar, buxhet familjar, buxhet fiks, buxhet financiar, buxhet gjithëpërfshirës, buxhet i baraspeshuar, buxhet i lakueshëm, buxhet i njësuar, buxhet i parave, buxhet i përgjithshëm, buxhet i prodhimit, buxhet i shitjeve, buxhet i shpenzimeve kapitale, buxhet integral, buxhet kreditor, buxhet neto, buxhet operacional,*

<sup>78</sup> A. Kostallari, “Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme “STUDIME MBI LEKSIKUN...”, II, 1972, f. 85.

<sup>79</sup> H. Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe, nga Rilindja deri në vitet '80 të shek. XX*, Tiranë, 2005, f. 122.

<sup>80</sup> A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 36.

<sup>81</sup> A. Kostallari, “Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972, f. 38.

*buxhet i parashikuar, buxhet i pavarur, buxhet plotësues, buxhet rregullues, buxhet i shtetit, buxhet valutor, buxhet vjetor etj.*

**Çmim** - *çmim i arit, çmim i arsyeshtëm, çmim i barabartë, çmim i blerjes, çmim i ditës, çmim i faturuar, çmim i fundit, çmim i kërkuar, çmim i konkurrencës, çmim i kontributit, çmim i kontrolluar, çmim i kostos, çmim i kripur, çmim i lartë, çmim i llogaritur për ndërtim, çmim i ndryshueshëm, çmim i ngritur, çmim i ofruar, çmim i papërballueshëm, çmim i pasluftës, çmim i përfaqësues, çmim i përkohshëm, çmim i posaçëm, çmim i prerë, çmim i prodhimit, çmim i publikuar, çmim i punës, çmim i rezervuar, çmim i rrezikut, çmim i shitjes, çmim i shitjes me pakicë, çmim i shitjes me shumicë, çmim i tregut, çmim i tregut botëror, çmim i tregut të brendshëm, çmim i ulët, çmim i ulur, çmim i veçantë, çmim importi, çmim konkurrues, çmim kontraktues, çmim maksimal, çmim me doganë, çmim me shtesë, çmim me zbritje etj.*

**Ekonomi** - *ekonomi amulluese, ekonomi asnjëse, ekonomi botërore, ekonomi e copëzuar, ekonomi dinamike, ekonomi e fshehur, ekonomi kombëtare, ekonomi e komanduar, ekonomi e mbyllur, ekonomi e mbyllur në borxhe, ekonomi e mirëqenies, ekonomi e orientuar në eksport, ekonomi e përzier, ekonomi e tregut, ekonomi e tregut të lirë, ekonomi jo tregu, ekonomi kombëtare, ekonomi me planifikim qendror, ekonomi e planifikuar, ekonomi politike klasike, ekonomi pozitive, ekonomi shtëpiake, ekonomi shtetërore, ekonomi shumëdegëshe, ekonomi tregu, ekonomi vendore etj.*

**Financë** – *financa funksionale, financa publike, financa të ndërmarrjeve, financa të centralizuara, financa të decentralizuara etj.*

**Kapital** – *kapital aksionar, kapital aksionar i emetuar, kapital aksionar i vlerësueshëm, kapital bazë, kapital fiks, kapital financiar, kapital fizik, kapital i bankës, kapital i deklaruar, kapital i emetuar, kapital i huazuar, kapital i investuar, kapital i kompanisë, kapital i kontribuar, kapital i luhatshëm, kapital i paguar, kapital i rrezikuar, kapital i vdekur, kapital i vet, kapital intensiv, kapital kombëtar, kapital nominal, kapital punues, kapital qarkullues, kapital shoqëror, kapital xhirues etj.*

**Kontabilitet** – *kontabilitet analitik, kontabilitet buxhetor, kontabilitet i burimeve njerëzore, kontabilitet i inventarit, kontabilitet i kompanisë, kontabilitet i kostos, kontabilitet i kostos vijuese, kontabilitet i veprimtarisë, kontabilitet i vlerës, kontabilitet i zhvlerësimit etj.*

**Kontratë** – *kontratë afatgjatë, kontratë afatshkurtër, kontratë bazë, kontratë blerjeje, kontratë dypalëshe, kontratë eksporti, kontratë fillestare, kontratë furnizimi, kontratë inxhinieringu, kontratë e këmbimit të lirë, kontratë e këstit të shtyrë, kontratë e lidhur, kontratë me afat të pacaktuar, kontratë e ndërmjetësimit, kontratë paraprake, kontratë për dërgimin e mallrave, kontratë e posaçme, kontratë e shkruar, kontratë e vlefshme etj.*

**Kosto** - *kosto e blerjes, kosto e borxhit, kosto e drejtpërdrejtë, kosto e inventarit, kosto e jetesës, kosto e konsumuar, kosto e llogaritur, kosto e mallrave të shitura, kosto e mbetur, kosto materiale, kosto mesatare, kosto ndihmëse, kosto normale, kosto e një investimi, kosto e pagave, kosto e përzier, kosto e plotë, kosto e porositjeve, kosto private, kosto e procesit, kosto e punës për njësi, kosto e shërbimit, kosto shfrytëzimi, kosto e supozuar, kosto e tërësishme, kosto e transportit etj.*

**Kursim** – *kursim i burimeve të punës, kursim i numrit të punëtorëve, kursim i objekteve të punës, kursim i punës së materializuar etj.*

**Mall** - *mall bazë, mall deficitar, mall eksporti, mall fals, mall gati për magazinim, mall gati për nisje, mall humanitar, mall i dëmtuar, mall i dyshimtë, mall i eksportuar, mall i gatshëm për përdorim, mall importi, mall i importuar, mall i konfiskuar, mall i konsumit të gjerë, mall i kthyer, mall i magazinuar, mall i mbivlerësuar, mall i monopolizuar, mall i ndaluar, mall i përpunuar, mall i piratëve, mall plotësues, mall i prodhuar në tërësi, mall i*

*rishitur, mall i rrezikshëm, mall i stivuar, mall i zgjedhur etj.*

**Para-***para ditore, para e lirë, para kontabël, para në dorë, para në rast emergjence, para nga aktivitetet operative, para spekulative, para të falsifikuara, para të fituara me djersë, para të gatshme, paraja si mjet pagese, pagesë me para etj.*

**Planifikim** - *planifikim i auditimit, planifikim i familjes, planifikim i fitimit, planifikim i fuqisë punëtore, planifikim i patundshmërive, planifikim i punës së drejtpërdrejtë, planifikim i resurseve të fabrikimit etj.*

**Prodhim-** *prodhim i gatshëm, prodhim i kontraktuar, prodhim i përgjithshëm, prodhim i përzier, prodhim i ri, prodhimi veçantë etj.*

**Pronë** – *pronë e banuar nga pronari, pronë e braktisur, pronë e çmueshme, pronë e paprekshme, pronë e patundshme, pronë e përbashkët, pronë e përfutur, pronë shtetërore, pronë private, pronë e siguruar etj.*

**Punë** - *punë abstrakte, punë e detyruar, pune e domosdoshme, punë e drejtpërdrejtë, punë fizike, punë ilegale, punë jashtë orarit, punë me kontratë, punë e kualifikuar, punë me kontratë, punë me mëditje, punë e përkohshme, punë me orar të përgjysmuar, punë e tërthortë, punë e thjeshtë, punë sheshtë, punë zyre etj.*

**Shitje-***shitje bruto, shitje e drejtpërdrejtë, shitje e garantuar, shitje ekipore, shitje fiktive, shitje masive, shitje me çmim të ulët, shitje me këste, shitje me kredi, shitje me para në dorë, shitje me ndërmjetësi, shitje me pakicë, shitje me pakicë me postë, shitje me pakicë me telefon, shitje me para në dorë, shitje me para të gatshme, shitje me porosi, shitje me postë, shitje me provë, shitje me shumicë me para në dorë, shitje në ankand, shitje nën çmim, shitje neto, shitje nga nevoja, shitje përcjellëse, shitje personale, shitje publike, shitje reale, shitje sipas gjedhës, shitje stinore etj.*

**Shpenzime** - *shpenzime administrative, shpenzime fillestare të investimeve, shpenzime gjyqësore, shpenzime kapitale, shpenzime kapitale fillestare, shpenzime publike, shpenzime reklame, shpenzime shkarkimi, shpenzime sheshtë, shpenzime sigurimi, shpenzime skajore, shpenzime standarde, shpenzime për ruajtje malli në magazinë, shpenzime të importit, shpenzime të kontrollit, shpenzime të manipulimit, shpenzime të mjedisit, shpenzime të ndryshueshme, shpenzime të paarsyeshme, shpenzime të pakontrollueshme, shpenzime të përgjithshme fikse, shpenzime të qerasë, shpenzime të shitjes, shpenzime të sigurimit, shpenzime transporti, shpenzime gjatë transitit etj.*

**Vlerë** - *vlerë e ardhshme e anuitetit, vlerë e barasvlershme në para, vlerë e bartur, vlerë e brendshme, vlerë e çmuar, vlerë e daljes, vlerë e deklaruar, vlerë e dorëzimit në para, vlerë e drejtë e tregut, vlerë e faturës, vlerë e faturimit, vlerë e këmbimit, vlerë e klientit, vlerë e licencës, vlerë e llogaritur, vlerë e mbetur, vlerë e mbetur e garantuar, vlerë e mbetur e paguarantuar, vlerë e negociuar e transferim, vlerë e një entiteti të posaçëm, vlerë e parasë në kohë, vlerë e përcaktuar, vlerë e pritur, vlerë e realizueshme në para, vlerë e rrezikuar, vlerë e shlyerjes, vlerë e siguruar, vlerë e tanishme, vlerë e tanishme e firmës, vlerë e tanishme neto, vlerë e tregut, vlerë e vërtetë e tregut etj.*

**Tatim** - *tatim i drejtpërdrejtë, tatim i dyfishtë, tatim i huaj, tatim i mbajtur, tatim i ndryshueshëm, tatim i përgjithshëm, tatim i sheshtë, tatim i shtyrë, tatim i veçantë, tatim i vlerësuar etj.*

**Tregti** - *tregti botërore, tregti detare, tregti e drejtuar, tregti elektronike, tregti e jashtme, tregti e lirë, tregti private, tregti e përgjithshme, tregti shtetërore etj.*

Në terminologjinë e ekonomisë përdoren edhe **togfjalëshat e zgjeruar**: *fitim bruto i shtyrë, fitim neto i përvjetshëm, fitim i thjeshtë i bankës, gjendje kolapse e tregut, instrument i kthimit të aksionit, kapital aksionar i vlerësueshëm, kategorizim i vendeve të punës, kontratë për transportin e mallit, kontratë pune e përkohshme, kontratë për bartjen e personave, magazinim i përkohshëm i mallit etj.*

### Përfundim

Si për termat fjalë edhe për termat-togfjalësha, kriteri i përzgjedhjes për t'u përfshirë në terminologjinë e ekonomisë kushtëzohet nga shkalla e njohjes dhe e përhapjes së tyre në ligjërimin e përgjithshëm. Sot është shtuar numri i termave e për pasojë edhe togfjalëshat terminologjikë që lidhen sidomos me ekonominë e tregut, me biznesin, me financat e kontabilitetin, me statistikën, me planifikimin, me tregtinë e jashtme e të brendshme, me informatikën etj., sepse është rritur ndjeshëm pesha specifike e profesioneve me të cilat lidhen këto terma. Në fjalorët shpjegues të viteve të fundit, termat togfjalësha kanë zënë vend më të plotë dhe më sistemor. Në togfjalëshat në përgjithësi shprehen mundësitë e zhvillimit kuptimor të fjalës, të cilat i realizon në lidhje me fjalët e tjera. Përdorimi i togfjalëshave terminologjikë jo vetëm i jep terminologjisë karakter sistemor, të lidhur hierarkik, po edhe krijon saktësi e qartësi të dukshme në zbulimin e përmbajtjes së termit, sepse elementet përbërëse të tij përmbajnë anë të caktuara të tipareve të nocionit. Pra, togfjalëshat terminologjikë dallohen për qartësi dhe saktësi më të madhe në shënimin e nocionit në krahasim me termat njëfjalësh. Ata po marrin një përhapje të madhe në terminologjitë e fushave të ndryshme të dijës e në veçanti në terminologjinë e ekonomisë, duke u bërë një pjesë e rëndësishme e leksikut të saj.

### Referencat

- [1] Duro, A. (1983): *“Sistemet terminologjike dhe dysorët terminologjikë në rrafshin e fjalëformimit të gjuhës shqipe të përqsur edhe me italishten, anglishten dhe rusishten”* disertacion, Tiranë, 1983.
- [2] Duro, A. (2009): *“Termi dhe fjala në gjuhën shqipe”*, Tiranë, 2009.
- [3] *“Fjalor i gjuhës shqipe”*, Tiranë, 1980.
- [4] *“Fjalor i termave të ekonomisë së transportit shqip-anglisht-frëngjisht-rusisht”*, ASHK IGJL, Tiranë, 2002.
- [5] Gorani, H.: *“Çështje të terminologjisë në fushën e ekonomisë”*, Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, (Punime nga Sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë, më 28 dhe 29 janar 1988), IAP f.197-2032
- [6] Pasho, H. (1984): *“Zhvillimi i terminologjisë së ekonomisë pas Çlirimit dhe pasqyrimi i saj në dy fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe”*, SF 1984/1, f. 49-72. Tiranë, 1984.
- [7] Pasho, H. (1982): *“Përdorimi i termave të ekonomisë”*. Gjuha jonë, 1982/2, f. 33-38, Tiranë, 1982.
- [8] Piht, H. (1985): *“Terminology: An Introduction”*, Kopenhagen, 1985.
- [9] Pllana, G.; Pllana, S. (2012): *“A conceptual connections on a word and term level in the terminology of Theoretical Mechanics (in Albanian and English)”*, Trans&MOTOAUTO'12 20<sup>th</sup> International scientific and technical Conference on transport, road-building, agricultural, hoisting & hauling and military technics and technologies 27.-29.06.2012, p. 3-4, ISSN 1313-0226 Varna, Bullgari, Varna, 2012.
- [10] Pllana, S.; Pllana, G. (2012): *“Rruga semantike e ndërtimit të terminologjisë së mekanikës teorike në shqip dhe anglisht”*, International Conference CHALLENGES TO STUDIES IN ENGLISH LANGUAGE, 1-2 qershor 2012, Universiteti i Tiranës, FGJH Departamenti i gjuhës angleze, Tiranë, 2012.
- [11] Pllana, S.; Pllana, G. (2012): *“Marrëdhëniet e leksikut terminologjik dhe jotermnologjik në lidhje me informacionin shkencor-teknik në fushën e mekanikës teorike”*, WISSENSCHAFTLICHE KONFERENZ, Literatur, Landeskunde und Komparatistik, Fremdsprachenfakultät der Universität Tirana, 29. Juni 2012, Tiranë, 2012.
- [12] Rexha, N. (2009): *“Fjalor i biznesit, ekonomikës dhe financës anglisht-shqip-anglisht”*, ASAU, Prishtinë, 2009.
- [13] Sager, J. (1990): *“A practical course in terminology processing”*, Amsterdam, 1990.
- [14] Thomai, J. (2006):, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.